



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0240**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Gëzime S. Gashi” B.I. kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: “632-24-1707-1-2-1” me 24/05/2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit ekonomik “Gëzime S. Gashi” B.I, me numër protokolli; 0240/2024, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: “632-24-1707-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovë.
2. Obligohet Autoriteti kontraktues, të bëjë ndryshim/ përmisim të kriterëve në Dosjen e Tenderit/ Njoftim për Kontratë, të dates, 29.02.2024, sipas konstatimeve të Panelit Shqyrtues, në arsyetim të vendimit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik “ProGlobal” SH.P.K., sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 29.02.2024, Komuna e Gjakoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: “632-24-1707-1-2-1”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 35,000.00 €.

Me 13.03.2024, OE “Gëzime S. Gashi”B.I. - ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 18.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gëzime S. Gashi”B.I me nr. 240/24 lidhur me aktivitetin “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: “632-24-1707-1-2-1”.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraparak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi”B.I janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon: “ OE “RRON 2019” fillimisht ka kërkuar sqarime për kriterin diskriminues “Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës” të përcaktuar në dosjen e aktiviteti të prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje”, mirëpo përgjigja e dhënë nga AK ishte e mangët, e pa qartë dhe jo në harmoni me LPP dhe Ligjin NR.08/L-137 për Pyjet. Pas marrjes se përgjigjes së AK në sqarimet e kërkuara, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK, mirëpo edhe ajo është refuzuar. Prandaj, me këtë ankesë e njoftojmë OSHP-në se AK Komuna e Gjakovës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje” ka përcaktuar si kriter “Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës”, e cila është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik si ekonomiciteti dhe efikasiteti, barazia në trajtim, jodiskriminimi dhe konkurrenca. Pra AK Komuna e Gjakovës në këtë aktivitet të prokurimit ka imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik potencial, duke e vendosur si kriter “Licencën nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës”. Përveç kësaj, përcaktimi në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje” me numër të prokurimit 632-24-1707-1-2-1 i kriterit “Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës” ndikon edhe në kufizimin e konkurrencës dhe në diskriminimin e OE potencila si dhe ia pamundëson AK përdorimin efikas, efektiv dhe ekonomik të parasë publike. Sipas Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet “Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës” duhet të kenë OE që merren me prerjen e drunjëve, por jo edhe OE që merren me tregtimin e tyre (drunjëve për ngrohje). Pasi që aktiviteti i prokurimit është “Furnizim me dru për ngrohje” dhe nuk ka të bëjë me prerjen e drunjëve, AK K. Gjakovë ka shkelur edhe nenin 25 Kriteret e përzgjedhjes, i RRPP, paragrafi 6, i cili thotë “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë” si dhe neni 8.4 të Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik i cili thotë “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptoj në lidhje me: i. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe ii. përdorim të drejtë të fondeve publike”. Pra ky kriter bien ndesh me parimet e prokurimit, nenin 1 dhe 7 të LPP, nenin 25, paragrafin 6 të RRPP si dhe me nenin 8.4 të Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Në bazë të Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet, neni 59 për shitjen e masës drunore nuk kërkohet licencë, sepse tregtim me mase drusore rregullohet me dokumentacionin tjetër të subjektit juridik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Gëzime S. Gashi” B.I konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Nenet 1, 6, 7 të LPP-së si dhe nenin 25 Kriteret e përzgjedhjes i Rrpp-

së. Prandaj, kërkojmë nga OSHP-ja që për ta nxitur konkurrencën në mes të O.E, për t'i trajtuar në mënyrë të barabarte OE e interesuar, si dhe për të siguruar përdorim ekonomik, efikas dhe efektiv të parasë publike, të nxjerrët këtë: Vendim Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE RRON 2019; dhe Të largohet nga dosja e tenderit kriteri i kërkuar "Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës".

*-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim-*

Operatori ekonomik Gëzime S. Gashi B.I., mc dt.13 03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru për ngrohje", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24- 1707-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-019-121. Autoriteti Kontraktues Komuna c Gjakovës. me datë 18.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, kërkesën e vendosur ne Dosjen e Tenderit që Operatoret Ekonomik te jene te Licencuar, e ka. bere konform: LIGJI NR.08/L-137 PER PYJET 1.27. Subjektet e licencuara - janë çdo institucion, ndërmarrje, kompani ose person fizik, që janë licencuar nga Ministria, të aftë për të ushtruar akt vitet të caktuara që parashihen me këtë ligj; Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thënë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 240/2024, ndërsa me datë 29.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/240 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

*-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE "Gëzime S. Gashi" B.I eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/240 ka vlerësuar si në vijim:*

Konstatimi i parë (I): "Autoriteti kontraktues ka kërkuar në nenin 9.1&9.2 të dosjes së tenderit: Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës për prerje dhe transport te druve për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore OE ankues, fillimisht ka kërkuar sqarime për kriterin diskriminues "Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës" të përcaktuar në dosjen e aktiviteti të prokurimit "Furnizim me dru për ngrohje", mirëpo përgjigja e dhënë nga AK ishte e mangët, e pa qartë dhe jo në harmoni me LPP dhe Ligjin NR.08/L-137 për Pyjet. Operatori ekonomik ankues në kërkesën për rishqyrtim e ka kundërshtuar këtë kërkesë me arsyetimin se licenca nuk kërkohet për shitje të druve, duke cekur Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet, neni 59. Eksperti shqyrtues ka analizuar Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet, ku në nenin 59 janë të parashikuara kushtet për transport të drurit. Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet (neni 57,58) parasheh leje për prerje në pyjet private dhe pyjet shtetërore dhe tregon procedurat e prerjeve. Licenca e kërkuar nga autoriteti kontraktues nuk haset që kërkohet në Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet. Ky aktivitet ka të bëjë me furnizim me dru për ngrohje dhe këtë furnizim mund ta bëjnë operatorët ekonomik të ndryshëm që janë marr me furnizime dhe që kanë përvojë në këtë lëmi ashtu siq është kërkuar në dosje që të ofrohen dëshmi për kontrata të ngjashme. Derisa nuk lëshohet licencë sipas Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet, dhe derisa ky tender është vetëm furnizim mendojë se licenca e kërkuar e kufizon konkurrencën dhe mendojë se duhet të largohet si kërkesë, me qëllim që të hapet tregu dhe konkurrenca. Andaj Eksperti shqyrtues, rekomandon që të aprovohet pretendimi ankimor i OE si dhe të plotësohet/ndryshohet kërkesa e AK, dhe të respektohet neni 53 i LPP."

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik me rastin e hartimit të kritereve të Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me dru per ngrohje” me nr. të prokurimit: "632-24-1707-1-2-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi”B.I dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi” B.I janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues lidhur me ankesën e OE “Gëzime S. Gashi”B.I me nr; 0224/2024, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, Dosjen e tenderit dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik, aprovohet si bazuar. Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru per ngrohje” me nr. të prokurimit: "632-24-1707-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, që lënda e këtij aktiviteti të prokurimit t,i kthehet Autoritetit Kontraktues, për ndryshimin përkatësisht të përmirësimit të kritereve të Dosjes së Tenderit, pasi ato nuk janë në përputhje me LPP-së.

Autoriteti kontraktues, Komuna e Gjakovës, Obligohet të bëjë ndryshim/përmirësimet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru per ngrohje” me nr. të prokurimit: "632-24-1707-1-2-1", në mënyrë që të mos krijohet konfuzitet e pabarazi/diskriminim në mes të OE të interesuar në aktivitetin e prokurimit, sipas konstatimeve të mëposhtme Panelit Shqyrtuese, të mbeshura në vlerësimet e bazuara, të raportit të ekspertit shqyrtues si në vijim;

Paneli shqyrtues konstaton se, kërkesa e Autoriteti kontraktues në Dosjes së Tenderit, në nenin 9.1&9.2: “Licencë nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës” është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lirë në treg në mes Operatorve ekonomik, andaj dhe Autoriteti kontraktues detyrohet ta largojnë këtë kërkesë nga Dosja e Tenderit.

Paneli shqyrtues konstaton se përmisimi i Dosjes së Tenderit do të ofrohej mundësi më të madhe për pjesëmarrje të OE-ve në aktivitetin e prokurimit, duke mos dëmtuar apo duke mos ulur cilësinë e produkteve/ushqimeve të kërkuara. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE OE “Gëzime S. Gashi”B.I, me nr; 2024/0240, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: